

VENDIM
Nr. 478, datë 23.6.2017

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË RESTAURIMIT TË ISH-GODINËS SË
LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE, NË VARËSI TË MINISTRISË SË
KULTURËS, ME QËLLIM AKOMODIMIN E ORGANEVE TË VETTING-UT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Restaurimin, në vlerën 103 000 000 (njëqind e tre milionë) lekë, të ish-godinës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, me qëllim sistemimin e ambienteve të saj aktuale në funksion të organeve të Vetting-ut.

2. Fondi i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, në masën 103 000 000 (njëqind e tre milionë) lekë, të përballohet nga fondet e buxhetit të vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Kulturës, zëri “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, në programin “Arti dhe Kultura”.

3. Këshilli i Ministrave, në rast të rishikimit të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, merr masa për kompensimin e vlerës, sipas pikës 1, të këtij vendimi, Ministrisë së Kulturës.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama